

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë, Çdo vit, kur diskutohet buxheti i arsimit në Kuvend, pyetja e parë dhe e vazhdueshme është: sa është rritur buxheti, në raport me vitin e kaluar? A e kemi arritur 5% të GDP-së? Sa për qind e shpenzimeve publike është? Natyrisht, buxheti është shumë i rëndësishëm, por unë mendoj që nuk mjafton vetëm të kërkojmë një buxhet të lartë, sepse, në radhë të parë, duhet të tregojmë që kemi kapacitet absorbues. Pra, një sfidë shumë e rëndësishme është se si ta përkthejmë këtë buxhet në të mira dhe në shërbime cilësore, më pas si ta zbatojmë sa më mirë atë, si t'u përgjigjemi sa më mirë prioriteteve që ka sot sistemi arsimor. Edhe pse ne nuk e arritëm dot 5% të PBBsë, ne arritëm që edhe pas dy fatkeqësive të mëdha natyrore, të rritim buxhetin për sektorin e arsimit me 15%, në raport me vitin 2021 ose në vlerë nominale 8,3 miliardë lekë më shumë, që përfaqëson 3,6% e PBB-së. Pa dyshim, lajmi i parë i mirë që sjell ky buxhet është rritja e pagave me 6% për të gjithë punonjësit mësimorë, edukatorë dhe psikosocialë, si vlerësim e shpërblim për punën e pakursyer për edukimin e fëmijëve tanë, por edhe për ta lartësuar akoma më shumë dinjitetin e tyre. Në mandatin e kaluar pagat u rritën me 32%, ndërkohë që për këtë mandat, objektivi ynë është jo vetëm ta kalojmë 32%, por, pse jo, të shkojmë drejt 40%. Këtë premtim ne po e mbajmë që në vitin e parë. Lajmi i dytë i mirë lidhet me investimet për përmirësimin e infrastrukturës shkollore, dhe këtu nuk e kam fjalën vetëm për ndërtesat apo terrenet sportive, por edhe laboratorët didaktikoshkencorë (kimi, biologji, fizike), si dhe laboratorët e informatikës që të garantojmë cilësi në mësimdhënie e mësimnxënie, sipas kurrikulës së re bazuar në kompetenca. Gjatë 8 vjetëve të kaluar ne kemi ndërtuar apo kemi rikonstruktuar mbi 300 shkolla në të gjithë vendin, ku shtohen pa dyshim edhe 70 shkolla tashmë të përfunduara me programin e madh të rindërtimit, të gjitha me standardet më të mira bashkëkohore.

Ndërkohë, puna vazhdon intensivisht edhe për shkollat e tjera të përfshira në këtë program, të cilat shpresojmë të përfundojnë sa më shpejt brenda vitit 2022. Për t'u përgjigjur nevojës për të investuar më shumë në modernizimin e laboratorëve dhe gjithë bazës materiale, buxheti parashikon 400 milionë lekë për të furnizuar rreth 100 shkolla me laboratorë didaktikë bashkëkohorë, për lëndët fizikë, kimi dhe biologji, si dhe 570 milionë lekë për fuqizimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në arsim. Veçanërisht për zbatimin e TIK-ut, ne do të ndërtojmë një infrastrukturë moderne të qëndrueshme, gjerësisht të përdorshme, në rreth 200 shkolla për të vazhduar me të njëjtin ritëm edhe për vitet 2023 e 2024. Lajmi tjetër i rëndësishëm lidhet me rritjen me 50% të buxhetit për transportin e nxënësve. Për fat të keq, sot një pjesë e procedurave nëpër drejtoritë rajonale dështojnë pikërisht për shkak të çmimit shumë të ulët të biletës së parashikuar në VKM-në përkatëse. Ndërkohë që ky problem lidhet edhe me klasat kolektive, në zonat e largëta rurale, ku transporti është i vështirë. Ne duam t'i çojmë nxënësit në shkolla normale, që të mësojnë me bashkëmoshatarët e tyre dhe me mësues të profilit në klasa normale, por nuk zgjidhim dot transportin. Edhe pse në 8 vjet ne e kemi përgjysmuar numrin e tyre, sot kjo mbetet një nga sfidat më të mëdha, për të cilën ne jemi të vendosur t'i përdorim të gjitha mundësitë dhe kapacitetet tona. Me buxhetin e

vitit 2022, me një fond prej 950 milionë lekësh do të sigurojmë mbulimin e shpenzimeve të transportit për rreth 35 mijë nxënës që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, me risinë që rimbursimi i biletës së tyre do të jetë 50% më shumë, si dhe transportin për rreth 12 mijë mësues që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi. Këtu, natyrisht, do të na duhet një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë aktorët lokalë, bashkitë dhe njësitë administrative nga njëra anë, dhe prindërit dhe komunitetin nga ana tjetër, sepse, nëse do të kemi më shumë buxhetim, më shumë bashkëpunim dhe më shumë ndërgjegjësim, pa dyshim do të kemi rezultate pozitive.

Ndërkohë, për sa u takon teksteve shkollore, tashmë siç e dini, me një buxhet prej 1,1 miliardë lekësh në vit ne ofrojmë tekste shkollore në përdorim falas për rreth 280 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë (deri në klasën e nëntë), duke përfshirë këtu 20 mijë nxënës të arsimit të mesëm të lartë nga shtresat sociale në nevojë. Për vitin e ardhshëm, ne angazhohemi që tekstet nga klasa e parë deri në klasën e tretë janë vetëm me një përdorim, ndërkohë që kemi filluar tashmë nga puna për të rishikuar në detaje të gjitha tekstet e arsimit parauniversitar për të korrigjuar çdo pasaktësi apo pasqyrim jo të përshtatshëm të realitetit. Nuk ka asnjë dyshim që tekstet që kemi sot, të përkthyer nga Oxford-i, Cambridge-i dhe Pearson-i janë shumë herë me cilësore se tekstet e mëparshme, por kjo nuk do të thotë të kënaqemi deri këtu, përkundrazi, të kërkojmë gjithmonë më të mirën dhe të ecim me hapin e kohës. Në pamundësi për t'u ndalur në detaje në të gjithë zërat e buxhetit parauniversitar, dua të theksoj se vëmendja jonë do të jetë e fokusuar akoma me shumë të nxënësit me nevoja të veçanta, ku risi do të jetë fillimi i punës për ndryshimet ligjore që t'i kthejmë shkollat speciale në qendra burimore. Po ashtu, me një buxhet 110 milionë prej lekësh do të ofrojmë bursa financiare për nxënës me nevoja të veçanta dhe fëmijë nga shtresat sociale në nevojë, me qëllim uljen e braktisjes shkollore. Po ashtu, edhe punonjësit psiko-socialë kanë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në shkollat tona për të mbështetur nxënësit dhe mësuesit, për të luftuar, sidomos për të parandaluar çdo fenomen negativ social, dhunën, bulizmin, abuzimin ndaj të miturve e çdolloj rreziku të mundshëm që mund të vijë brenda shkollës, por edhe jashtë saj.

Vitin e kaluar ne dyfishuam numrin e punonjësve psiko-socialë në shkollat tona, por ende nuk mjafton, se ne duhet t'u garantojmë shërbim cilësor të gjithë nxënësve jo vetëm atyre që janë në qendrat e qyteteve, por edhe atyre që janë në zonat të largëta, ku shkollat kanë pak nxënës, por përsëri këta nxënës kanë të drejtë ta marrin këtë shërbim njëlloj si nxënësit që janë në qendrat e qyteteve. Për sa i përket buxhetit për arsimin e lartë, ai shënon një rritje prej 9% ose 910 milionë lekësh më shumë se buxheti i vitit 2021, ku prioriteti kryesor do të jetë pa dyshim ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë, me një fond grand prej 800 milionë lekësh, në varësi të aplikimeve nga vetë institucionet e arsimit të lartë.

Tashmë kemi filluar punën për hapjen e filialeve të universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri dhe për programe të përbashkëta studimi dhe të dyfishta me to në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhën angleze. Kjo jo vetëm do të ndihmojë për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në përgjithësi dhe të cilësisë së këtyre programeve në veçanti, por do t'u japë më shumë vlerë diplomave të studentëve tanë, në mënyrë që t'i bëjë ata më konkurrues edhe në rajon, edhe në tregun europian apo ndërkombëtar të punës. Investimet infrastrukturore në kampuset universitare do të vazhdojnë. Kemi bërë tashmë një punë shumë të mirë me pjesën më të madhe të rezidencave studentore në të gjitha universitetet, por këto investime do të vazhdojnë për Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Tiranës, Universitetin e Arteve, Akademinë e Policisë e kështu me radhë. Edhe mbështetja jonë për studentët do të vazhdojë pa diskutim, si për studentë ekselentë apo studentë nga shtresa sociale në nevojë, sikurse edhe buxheti për kërkimin shkencor, i cili për vitin 2022 ka një rritje me 9% ose 66 milionë lekë më shumë krahasuar me vitin 2021. Së fundi, por jo më pak i rëndësishëm, sporti. Prioritet do të jenë investimet në sport për ndërtimin, rindërtimin e objekteve apo të terreneve sportive. Kemi investuar në 8 vjet, si kurrë më parë, stadiumet e Elbasanit, të Tiranës, të Shkodrës, të

Kukësit. Do të vazhdojmë me 270 milionë lekë, jo vetëm në mbështetje të federatave dhe të klubeve sportive, por për t'u ofruar qytetarëve dhe për të nxitur, sidomos të rinjtë, për një jetë sportive të shëndetshme, larg veseve apo fenomeneve negative sociale. Do ta vazhdojmë dyfishimin e klasave sportive në shkolla, shtimin e disiplinave, fuqizimin e sportit shkollor edhe atij universitar, duke organizuar më shumë kampionate në nivel bashkie, qarku apo në nivel kombëtar. Koha mbaroi, por dua të theksoj diçka të fundit: nëse do t'i vendosim një emër buxhetit për arsimin, pa dyshim që do të quhej buxheti i infrastrukturës, digjitalizimit dhe i ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë. Prandaj, ju ftoj të gjithëve ta mbështesim jo vetëm me votën pro këtu në Kuvend, por edhe gjatë zbatimit të tij më vonë